

PËRPIJEKJET E INTELIGJENCËS SHQIPTARE JASHTË VENDIT PËR ARSIM NË GJUHËN AMTARE

ALBANIAN INTELLIGENCE EFFORTS ABROAD FOR EDUCATION IN THE MOTHER TONGUE

Zejni MAZLLAMI¹, Hasan SALIU²

¹Department of History, Faculty of Philosophy, University of Tetova

²Department of History, Faculty of Philosophy, University of Tetova

*Corresponding author e-mail: zejni.mazllami@unite.edu.mk, hasan.saliu@unite.edu.mk

Abstract

The commitment of Albanians to education and learning in their native language in the period 1878-1912 marked a new phase. During this period, the Albanian intelligentsia abroad founded several associations that supported the opening of schools with instruction in the Albanian language, the printing of textbooks, magazines and newspapers in the Albanian language. The Albanian Renaissance people had concluded that the teaching of the native language is an expression of the existence of the Albanian nation. The largest number of Albanian intellectuals who were part of the national movement for education in the native language were located in the main Balkan and European capitals such as Istanbul, Bucharest, Sofia, Rome, Vienna, etc.

Keywords: Albanian intelligence, education, mother tongue, associations.

Abstrakt

Angazhimi i shqiptarëve për arsim dhe mësim në gjuhën amtare në periudhën 1878-1912 shënoi një fazë të re. Gjatë kësaj periudhe, inteligjenca shqiptare jashtë vendit themeloi disa shoqata që mbështesnin hapjen e shkollave me mësim në gjuhën shqipe, shtypjen e teksteve shkollore, revistave dhe gazetave në gjuhën shqipe. Rilindasit shqiptar kishin arritur në përfundimin se mësimi i gjuhës amtare është shprehje e ekzistencës së kombit shqiptar. Numri më i madh i intelektualëve shqiptarë që ishin pjesë e lëvizjes kombëtare për arsim në gjuhën amtare ndodheshin në kryeqytetet kryesore ballkanike dhe evropiane si Stamboll, Bukuresht, Sofje, Romë, Vjenë, etj.

Fjalë kyçe: inteligjenca shqiptare, arsim, gjuhë amtare, shoqata.

Vizioni i inteligjencies shqiptare jashtë vendit për arsimin në gjuhën amtare

Intelektualët shqiptar jashtë vendit arritën në përfundim se mësimi i gjuhës amtare kishte një rëndësi të jashtëzakonshme, si një objekt vëllazërimi midis shqiptarëve të ndarë në tre fe të ndryshme. Prandaj, si qëllim kryesor të aktivitetit të tyre ata kishin arsimin në gjuhën amtare¹. Pothuajse të gjithë rilindasit ishin të bindur se gjuha amtare mund të ruhej vetëm nëse shkruhej më të dhe nëse përdorej në mësimdhënie, sipas tyre, arsimit dhe kultura kombëtare mund të zhvillohej vetëm përmes gjuhës amtare.

Të gjithë shqiptarët duhej të arsimoheshin në gjuhën amtare që të mund të mbrohej kombi nga asimilimi. Konstantin Kristoforidhi shkruante: “*Shqipëria nuk mund të përparojë në asnjë gjuhë të huaj, përveçse në gjuhën amtare. Vetëm atëherë, kur gjuha amtare të futet në arsim, mund të shpresojmë të jemi në rrugën e kombeve të tjera të përparuara të Evropës*”. Të njëjtën ide e kishte edhe Sami Frashëri, i cili shkruante: “*Nuk mund të ketë Shqipëri pa shqiptarë, nuk*

¹ Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Historia e popullit shqiptar*, v. II, Rilindja Kombëtare vitet 30 të shek XIX-1912, Tiranë 2002, f. 126.

<https://doi.org/10.62792/ut.albanologjia.v12.i23-24.p3134>

*mund të ketë shqiptarë pa gjuhën shqipe, nuk mund të ketë gjuhë shqipe pa shkolla ku mësohet gjuha shqipe*².

Në Stamboll, më 12 tetor 1879, në një takim të përfaqësuesve shqiptarë nga krahina të ndryshme shqiptare u vendos që të themelojë *Shoqëria e të Shtypurit Shkronja Shqip* (shkurt: *Shoqëria e Stambollit*) me kryetar Sami Frashërin. Detyra kryesore kishte të nxirrte shoqërinë shqiptare nga prapambetja duke zhvilluar arsimin kombëtar nëpërmjet botimit të librave.

Përdorimi i të ashtuquajturit “Alfabet i Stambollit” si alfabet i gjuhës shqipe krijoi kushte për botimeve e teksteve shkollore dhe veprave letrare në gjuhën shqipe. Në këtë mënyrë, u bë e mundur edhe hapja e shkollave shqipe, të cilat u panë nga rilindasit si subjekti kryesor për zhvillimin kulturor dhe ngritjen e popullit shqiptar³.

Një rol të rëndësishëm në përpjekjet për arsim në gjuhën amtare luajti Hasan Tahsini, një figurë e shquar në shkencë. Hasan Tahsini nuk pushoi kurrë së provuari se të mësuarit e gjuhës shqipe, dhe mos përdorimi i shkronjave arabe, nuk ishte aspak kundër frymës së Kur’anit⁴. Një nga intelektualët më të shquar të kësaj periudhe, Faik Konica, parashikoi shpërbërjen e shpejtë të Perandorisë Osmane.

Më 18 prill 1896, ai shkruante: “*Shteti osman pas një çerek shekulli nuk do të sundojë më në Shqipëri*”. Megjithatë, Konica shprehu shqetësimin e tij për kohën kur kjo po ndodhte, dhe shqiptarët mund të binin nën sundimin e shteteve fqinje. Kush do ta mbrojë atdheun? - pyeti Konica. Në një artikull në gazetën “Shqipëria e Vogël”, nr. 2, në vitin 1903, Konica nxjerr në pah mungesën e mbështetjes së jashtme për realizimin e të drejtave të popullit shqiptar. “*Kur popujt sllavë të Ballkanit kishin të drejta, përfshirë të drejtën për të hapur shkolla në territore të banuara plotësisht nga shqiptarë, këtyre të fundit iu mohua një gjë e tillë. Nëse shqiptarët do të ishin sllavë, gjërat do të ishin ndryshe, sepse ne jemi ato që jemi dhe nuk ka askush që të flasë në emrin tone*”⁵.

“Albania” ishte gazeta më e njohur e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, me parametra evropianë. Me të bashkëpunuan intelektualët më të shquar shqiptarë, si: Luigj Gurakuqi, Hill Mosi, Sotir Peci, Fan Noli, Ndoc Nikaj, Filip Shiroka, Aleksandar Xhuvani, Ndre Mjeda, si dhe albanologë të shquar botërorë, si Mayer, Pedersen, Lengard e të tjerë. “Albania” ishte një gazetë kombëtare me karakter të përgjithshëm (enciklopedik), ishte zëri i mendimit të lirë i intelektualëve shqiptarë për çështje të ndryshme politike, shkencore, gjuhësore, arsimore, letrare e të tjera⁶. Në këtë lëvizje morën pjesë edhe intelektualë me origjinë shqiptare në Itali (arbëreshët), të cilët dhanë një ndihmesë të çmuar në avancimin e çështjes kombëtare. Një rol të rëndësishëm pati Jeronim de Rada, si shkrimtar dhe studiues i shquar. Në afirmimin e gjuhës shqipe dhe historisë së Shqipërisë u dallua edhe Elena Gjika (Dora d’Istria), autore e veprës “Shqiptarët” në frëngjisht⁷.

Midis shumë intelektualëve, Anselmo Lorezio u dallua me shkrimet e tij në trajtimin e çështjes kombëtare shqiptare, veçanërisht në faqet e gazetës “La nazione Albanese”, të cilën e themeloi dhe e financoi vetë ai. Numri i parë i kësaj reviste u botua në vitin 1878, në një kohë kur çështja shqiptare ishte në një gjendje delikate. Qëllimi i Lorezios dhe i bashkëmendimtarëve të saj ishte ta vendosnin çështjen shqiptare në qendër të vëmendjes si një çështje që duhej zgjidhur, përpara opinionit evropian, veçanërisht atij italian⁸.

Kolonitë shqiptare në Rumani dhe Bullgari, pasi ishin më të shumta në numër dhe më të fuqishme për nga aspekti material, dhe vepronin në rrethana më të lehta politike, morën një rol të veçantë dhe shumë të rëndësishëm në lëvizjen kombëtare, duke ndihmuar në ngritjen e

² Po aty, f. 248.

³ Ferit Duka, *Shekujt osmanë në hapësirën shqiptare (studime dhe dokumente)*, Tiranë, 2009, f. 406.

⁴ *Historia e popullit shqiptar*, v. II, *Rilindja Kombëtare vitet 30 të shek XIX-1912*, f. 128.

⁵ Fehari Ramadani, et al., *Raportet e Faik Konicës me Austro-Hungarinë (1897-1912)*, në: *Albanologjia*, nr. 1-2, Tetovë, 2014, f. 33; 38.

⁶ Hajrulla Koliqi, *Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar*, Prishtinë, 2002, 190

⁷ *Historia e popullit shqiptar*, v. II, *Rilindja Kombëtare vitet 30 të shek XIX-1912*, f. 130-131.

⁸ Lavdosh Ahmetaj, *Kontributi i shqiptarëve të Italisë në funksion të çështjes shqiptare*, në: *Studime Albanologjike*, nr. 3, Shkup, 2011, f. 35-43.

shtypshkronjave për shtypjen e teksteve shkollore në gjuhën shqipe, duke botuar revista dhe gazeta shqipe dhe duke hapur shkolla kombëtare në gjuhën shqipe⁹.

Shoqëria shqiptare “Drita” në Bukuresht fillimisht u themelua si degë (1881) e Shoqërisë së Stambollit. Më 27 dhjetor 1894, ajo fitoi pavarësinë dhe mori emrin “Drita”. Më 4 janar 1887, “Drita” u riorganizua, nën udhëheqjen e Nikolla Naços. Sipas Statutit të ri, në ditët e para të aktivitetit të saj, ajo themeloi degë në qendrat rumune ku ndodheshin emigrantët shqiptarë, si në Braila, Konstancë, Kraiovë, etj. Shoqëria “Drita”, nëpërmjet aktiviteteve të saj, zhvilloi një veprimtari të pasur në rizgjim kombëtar, duke filluar me hapjen dhe organizimin e shkollave të para kombëtare shqipe në Shqipëri (1887-1892), pastaj hapjen e shkollës së parë normale shqipe në Bukuresht (10 maj 1892), hapjen e shkollës së parë shqipe për vajza në Korçë, shkollën shqipe “Drita” në Konstancë në vitin 1905, me mësues Asdrenin¹⁰.

Në artikullin me titull Çfarë kërkojmë?, të botuar në numrin e parë të gazetës “Shqipëtar”, u përcaktua shkurtimisht programi i shoqatës “Drita”: 1) Përdorimi i gjuhës shqipe në shkolla dhe kisha; 2) Ngritja e degëve kulturore dhe hapja e shkollave shqipe; 3) Zhvillimi i gjuhës, historisë dhe letërsisë kombëtare; 4) Shtypja e teksteve shkollore, revistave dhe gazetave në gjuhën shqipe¹¹.

Në nëntor të vitit 1898, u mbajt një mbledhje e zgjeruar e kolonisë shqiptare në Bukuresht, e cila u vlerësua nga shtypi i kohës si një kongres i shqiptarëve kushtuar zgjerimit të shkollave shqipe. Në Kongres u shqua Dervish Hima, kryetar i rrethit të studentëve shqiptar në Bukuresht¹².

Në Bullgari, rol të rëndësishëm në përhapjen e ideve kombëtare dhe alfabetit shqip midis emigrantëve luajti Dhimitër Mole, i cili shkoi atje nga Bukureshti në janar të vitit 1886. Në janar 1893, u themelua Shoqëria shqiptare “Dëshira”, me statutin dhe fondin e vet. Në pikën 2 të Statutit, thuhet: *“Qëllimi i Shoqërisë ‘Dëshira’ është përhapja e dijes dhe e mësimit në gjuhën amtare, si dhe hapja e shkollave në gjuhën amtare në Shqipëri”*. Ligor Marko u zgjodh kryetar i shoqatës, dhe Dhimitër Mole ishte sekretar. Shoqata krijoi degët e saj në qytete me ku banonin shqiptarë, si Varnë, Plovdiv, etj. Aktivitetet e shoqatës “Dëshira” u zgjeruan edhe më shumë në vitet e fundit të shekullin XIX, kur në Sofje u krijua shtypshkronja “Përparimi”, ku u shtypën shumë libra dhe revista në gjuhën shqipe¹³.

Jashar Sadiku, i njohur edhe si Jashar Erebara, ishte ndër nxënësit e parë në shkollën e mesme shqipe në Bukuresht. Në vitin 1901 ishte kryeredaktor të gazetës “Selamet Arnautluk”, e cila botohej në Bukuresht. Në vitin 1902, në Beograd, ai organizoi botimin e gazetës “Albania” me moton *“Ballkani ballkanasve, Shqipëria shqiptarëve”*. Në vitet 1911-1912, Jashar Erebara drejtoi gazetën “Shkupi”, në Shkup. Ai u angazhua gjatë gjithë jetës së tij në hapjen e shkollave dhe shtypjen e librave, revistave dhe gazetave në gjuhën amtare¹⁴.

Përfundim

Kërkesat politike të shqiptarëve, si dhe kërkesa për arsimim në gjuhën amtare, iu paraqitën publikut të gjerë evropian përmes shumë shkrimeve historike, etnografike, revistave dhe gazetave, ku padzshim “Albania”, kishte rolin kryesor. Në lëvizjen kombëtare shqiptare për arsim në gjuhën amtare morrën pjesë edhe intelektualë të njohur evropianë me origjinë shqiptare, si Jeronim de Rada, Elena Đika (Dora d’Istria) dhe Anselmo Lorezio. Kolonitë shqiptare në Rumani dhe Bullgari, dhanë ndihmesë të madhe në themelimin e shtypshkronjave,

⁹ Historia e popullit shqiptar, v. II, Rilindja Kombëtare vitet 30 të shek XIX-1912, v. 241.

¹⁰ Ismet Dërmaku, Shoqëria e mësimit shqip “Drita” e Bukureshtit në zgjimin dhe çlirimin kombëtar (1884-1914) sipas dokumenteve më të reja arkivore, Prishtinë 2009, v. 7.

¹¹ Historia e popullit shqiptar, v. II, Rilindja Kombëtare vitet 30 të shek XIX-1912, f. 244.

¹² Po aty, f. 330.

¹³ Historia e popullit shqiptar, v. II, Rilindja Kombëtare vitet 30 të shek XIX-1912, f. 244-245.

¹⁴ I. Dërmaku, Shoqëria e mësimit shqip “Drita” e Bukureshtit në zgjimin dhe çlirimin kombëtar (1884-1914), f. 112.

shtypjen e teksteve shkollore në gjuhën shqipe dhe botimin e revistave dhe gazetave shqipe, si dhe hapjen e shkollave në gjuhën shqipe.

Referencat

- [1]. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Historia e popullit shqiptar II, Rilindja Kombëtare vitet 30 të shek XIX-1912*, Tiranë 2002.
- [2]. Fehari Ramadani, etc., *Raportet e Faik Konicës me Austro-Hungarinë (1897-1912)*, në: Albanologjia, nr. 1-2, Tetovë, 2014.
- [3]. Ferit Duka, *Shekujt osmanë në hapësirën shqiptare (studime dhe dokumente)*, Tiranë, 2009
- [4]. Fehari Ramadani, *Kontributi i Austro-Hungarisë për zhvillimin e arsimit dhe kulturës shqiptare 1900-1912*, Tetovë, 2010.
- [5]. Hajrulla Koliqi, *Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar*, Prishtinë, 2002.
- [6]. Ismet Dërmaku, *Shoqëria e mësimi shqip "Drita" e Bukureshtit në zgjimin dhe çlirimin kombëtar (1884-1914) sipas dokumenteve më të reja arkivore*, Prishtinë 2009.
- [7]. Lavdosh Ahmetaj, *Kontributi i shqiptarëve të Italisë në funksion të çështjes shqiptare*, në: Studime Albanologjike, nr. 3, Shkup, 2011.